



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Rahovec - Opštine Orahovac
Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu

Data - Datum	15.04.2019
Referencë/a	08 nr. 18/2019
Për/Za/To:	Rexhep Ahmet Pista nga Rahoveci
Zona Kadastrale:	Rahovec
Përmes/ Prekp/Through:	Afrim Oruçi - Drejtor Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, dhe Pronë
Nga/Od/From/	Sektori për pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Konkluzë

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për Pronë K. K. Rahovec duke vendosur sipas kërkesës (njoftimit) të Drejtorisë për punë – inspektuese, inspektori i ndërtimtarisë 14 nr. 1090/2019 më datë 04.04.2019 me të cilën ka kërkuar që të zhvillohet procedura e uzurpimit arbitrar të pasurisë shtetërore, kundër të dyshuarit Rexhep Ahmet Pista nga Rahoveci, në bazë të nenit 4 të Ligjit mbi shqyrtimin e marrëdhënieve pasurore të krijuara me uzurpim arbitrar të tokës në pronësi shtetërore, (“Gazeta Zyrtare e KSAK”, nr. 37/88) dhe nenit 21 të Ligjit të procedurës administrative nr. 05/L-031 merr:

K O N K L U Z Ë

NDERPRITET procedura e filluar kundër **Rexhep Ahmet Pista** nga Rahoveci, pasi që i përmenduri nuk ka uzurpuar pjesën parcelës shtetërore nr. **5069-0** Z. K. Rahovec në pronësi të P. SH. E KOSOV. K. K. RAHOVEC RRUGET.

A r s y e t i m

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori për Pronë i K. K. Rahovec duke vendosur sipas njoftimit të Drejtorisë për punë inspektuese, në çështjen administrative – uzurpim të tokës në

pronësi shtetërore, ka hapur procedurën kundër Rexhep Ahmet Pista nga Rahoveci, për shkak të dyshimit se i përmenduri me hedhjen e mbeturinave të ngurta dhe gjësendeve tjera në parcelën shtetërore nr. **5069-0** Z. K. Rahovec, ka uzurpuar pjesën e kësaj parcele shtetërore, në pronësi të P. SH. E KOSOV. K. K. RAHOVEC RRUGET.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në vendin e ngjarjes, eksperti teknik - gjeodeti ka bërë matjen dhe incizimin e parcelës në fjalë dhe ka përpiluar skicën e terrenit, në të cilën shihet qartë se mbeturinat dhe gjësendet tjera të hedhura nuk janë në parcelën shtetërore nr. **5069-0** por janë në parcelat e veta në të cilën i posedon i dyshuari.

Kjo drejtori duke u bazuar në të dhënat nga matjet e kryera nga eksperti teknik - gjeodeti, në të cilën shihet qartë se nuk ka uzurpuar pjesën e ngastrës shtetërore, vendosi që lidhur me këtë çështje administrative, procedura e filluar kundër tij të **ndërpritet**, sipas nenit 4 të Ligjit mbi shqyrtimin e marrëdhënieve pasurore të krijuara me uzurpim arbitrar të tokës në pronësi shtetërore ("Gazeta zyrtare e KSAK" nr. 37/88).


U vendos pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori i Pronës K. K. Rahovec, më 15.04.2019

08 nr. 18/2019

KESHILLA JURIDIKE : Kundër këtij vendimi mund të parashtrohet ankesë në Agjencinë Kadastra të Kosovës, Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi, nëpërmjet kësaj drejtorie.

HARTUESI

Jur. i. Diplumar. Nazmi Krasniqi



DRJETORI

Afrim Oruqi

